



REPUBLIKA E SHQIPË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 2763 / prot. 6

Tiranë, më 08.06.2021

URDHËR

Nr. 765, datë 08.06.2021

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT “POLITIKA E ARSIMIMIT DHE KUALIFIKIMIT
TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËR PËRPARIMIN NË GRADË

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “f”, pikës 2, të nenit 13, të ligjit 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritet e drejtimit e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 20, të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,


URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit “Politika e arsimit dhe kualifikimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përpërimin në gradë”, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: komandantët e Forcave/Mbështetëse, repartet autonome të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm.
3. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 1083, datë 30.05.2017 “Koncepti i arsimit dhe trajnimit individual të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
4. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Niko Peleshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

POLITIKA

**E ARSIMIMIT DHE KUALIFIKIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR PËRPARIMIN NË GRADË**

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 765, datë 08.06.2021

Tiranë, Maj 2021

KREU I

1. Hyrje

Rritja e profesionalizmit, ndërveprimit dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përmbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, zbatimi i dokumenteve strategjike, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përballimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve, kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe trajnimit individual të personelit, për ta bërë atë sa më cilësorë e fleksibël, në funksion të zhvillimit të vetë Forcave të Armatosura dhe të shoqërisë.

Arsimimi duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i paraprijë transformimit të FARSH-it, duke përmirësuar metodologjinë, programet mësimore e doktrinat ushtarake, hartuar dhe rishikuar procedurat standarde, për të normëzuar e unifikuar proceset dhe për të siguruar ndërveprueshmërinë me aleatët, me qëllim që t'u përgjigjet nevojave kombëtare, realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe të jetë në përputhje me sistemin e arsimit vendas dhe të vendeve anëtare apo partnere të NATO-s.

Në këtë kontekst kërkohet që procesi i arsimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak të konsolidohet më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO-s. Objektivi kryesor i këtij sistemi duhet të jetë mbështetja e FARSH-it me personel profesional, për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operationale, ku përparësi të mbetet përgatitja e ushtarit, nënoficerit dhe oficerit të trupës e shtabeve në të gjitha nivelet.

2. Qëllimi.

Zhvillimi i një sistemi të vetëm, të hapur, gjithëpërfshirës, të plotë, të unifikuar e të standardizuar, në përputhje me nevojat dhe kushtet e reja, për t'iu përgjigjur kërkesave e detyrimeve që shtrohen përpara një force, anëtare e NATO-s.

Politika e arsimit dhe kualifikimit të ushtarakëve të FA-së për përparimin në gradë, përcakton vizionin, parimet, objektivat, sistemin dhe përgjegjësitë për arsimimin dhe kualifikimin e të gjitha kategorive të ushtarakëve të FARSH-it, për përparimin në gradë, si dhe përcakton procedurat që duhen ndjekur dhe kriteret që duhen zbatuar për ndjekjen e kurseve institucionale, të cilat janë parësorë për promovimin e ushtarakëve. Ky dokument ofron qasjen e zbatimit të kriterëve në përmbushjen e kërkesave të ligjit.

3. Fusha e zbatimit.

Kërkesat e kësaj politike janë të detyrueshme për të gjithë personelin ushtarak dhe strukturat e FA-së.

4. Vizioni dhe parimet.

Arsimimi dhe trajnimi janë pjesë e konceptit strategjik, politikave dhe procedurave të menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore në FARSH. Politikat dhe procedurat e arsimit dhe trajnimit individual, duke qenë një pjesë më vete e ciklit jetësor të burimeve njerëzore, ndërveprojnë njëkohësisht edhe me pjesët e tjera të këtij cikli, veçanërisht me politikat

e rekrutimit, emërimit dhe të kohës së qëndrimit në detyrë, si dhe të promovimit në gradë dhe karrierë.

Sistemi ynë i arsimimit dhe trajnimit individual të personelit të FARSH-it siguron përgatitjen e kandidatëve për oficerë të rinj, si dhe të gjithë personelin ushtarak për specialitete të nevojshme, në përputhje me misionet e detyrat e strukturave operacionale e mbështetëse të Forcave të Armatosura dhe me nevojat për ndërveprim me strukturat e Aleancës.

Këtij sistemi i përgjigjen programe arsimimi e trajnimi ushtarak të kohës, të integrueshme, gjithëpërfshirëse, me kohëzgjatje e koston më optimale, të cilat do të mundësojnë përgatitjen e ushtarakëve të aftë dhe të gatshëm për të përballuar me profesionalizëm kompleksitetin e misionëve.

Sistemi i arsimimit ushtarak të oficerëve është pjesë integrale e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Si i tillë, në bazë të ligjit të arsimit të lartë krijon mundësinë e integritetit të programeve dhe kurrikulave, në përputhje me këtë ligj dhe udhëzimeve të herëpashershme të MASR-së. Sistemi ynë i arsimimit dhe trajnimit individual të personelit i përgjigjet ndryshimeve në doktrina, pajisje dhe teknologji.

Arsimimi dhe Trajnimi Institucional janë dy shtyllat kryesore që sigurojnë përgatitje intelektuale dhe profesionale të personelit dhe synojnë formimin metodologjik në pikëpamje teorike dhe aplikative dhe aftësimin e nevojshëm profesional në komandim, drejtim, komunikim, informacion, taktikë.

Kualifikimi dhe trajnimi funksional të përdoret gjerësisht si pjesë përbërëse e sistemit të arsimimit dhe kualifikimit, me qëllim plotësimin e kërkesave të forcave për aftësimin e personelit ushtarak në kryerjen e detyrës organike funksionale. Programi i kualifikimit dhe trajnimi funksional do të plotësojë nevojat për aftësimin e mëtijshëm në detyrat funksionale, si dhe dhënien e njohurive të nevojshme për armatim, teknikë, pajisje, sisteme apo procedura të reja standarde të NATO-s.

Vetëzhvillimi është përgjegjësi vetjake e personelit. Ndërkohë, komandantët dhe drejtuesit kanë detyrimin që të nxitin personelin vartës për vetëkualifikim në shërbim të funksioneve dhe detyrave që kryejnë, duke iu krijuar kushte të përshtatshme për këtë qëllim.

Hartimi dhe realizimi i programeve të arsimimit dhe trajnimit individual të mbështetet dhe të sigurohet nga një trupë profesionale dhe e motivuar komanduese, drejtuese dhe mësimdhënëse. Në funksion të këtyre programeve, infrastruktura e AFA-së të ofrojë kushte normale për arsimim, trajnim, jetesë, argëtim, si dhe për zhvillimin fizik.

Të gjithë personelit të FARSH-it t'i jepen mundësi të barabarta për të konkurruar për nevoja arsimimi e trajnimi institucional dhe funksional, në përputhje me nevojat e zhvillimit profesional individual. Përzgjedhja e personelit për arsimim dhe trajnim do të bëhet duke u dhënë përparësi më të kualifikuarve në bazë të nevojave dhe kërkesave për plotësimin organik të strukturave të Forcave të Armatosura.

5. Objektivat.

Sistemi dhe programet e arsimit dhe trajnimit individual të personelit të zhvillohen në përputhje me standardet kombëtare të arsimit, si dhe standardet e arsimit dhe trajnimit të vendeve të NATO-s.

Sistemi i arsimit dhe trajnimit të personelit të zhvillohet dhe konsolidohet, me qëllim që t'i paraprijë kërkesave dhe pritjeve të transformimit, ndryshimeve në doktrina, pajisje dhe teknologji, rritjes së kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcave të Armatosura, si dhe përmbushjes së misionit të detyrave të sotme dhe të ardhmes në FA, në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të sigurohen programe të integrueshme, gjithëpërfshirëse, me qëllim harmonizimin e kërkesave të arsimit, kualifikimit e trajnimit të personelit të FA-së, si dhe harmonizimi i sistemit të arsimit dhe trajnimit individual institucional me atë funksional.

Programet dhe kurrikulat e arsimit dhe trajnimit të personelit të sigurojnë plotësimin e kërkesave për formimin e aftësive bazë në nivelin taktik, operacional dhe strategjik, rritjen e performancës dhe cilësisë së lidershit. Çdo program arsimi, kualifikimi dhe trajnimi individual të përmbajë standardet (formatet) përkatëse të aftësive, shprehive dhe cilësive që do të arrihen, të cilat të jenë të matshme, të kontrollueshme dhe të testueshme.

Planet e arsimit, kualifikimit dhe trajnimit individual të personelit, si dhe planet përkatëse të mbështetjes të përfundojnë e të miratohen, jo më pak se 6 muaj përpara vitit pasardhës.

Programet e arsimit dhe trajnimit individual të oficerëve dhe nënoficerëve të zhvillohen edhe në gjuhën angleze, sipas STANG 6001, objektivit të aftësive/kapaciteteve E 1101 N. Në kurset e arsimit për oficerë K5, K6 dhe nënoficerë KKK, 20% e programit të zhvillohet në gjuhën angleze, si gjuhë operacionale e NATO-s. Të avancojë programi i trajnimit të personelit pjesëmarrës në operacione ushtarake ndërkombëtare në gjuhën e vendit ku dislokohe.

6. Autoritetet dhe strukturat përgjegjëse.

Ministri i Mbrojtjes është autoriteti i cili përcakton politikat e arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në përputhje me nevojat e FA-së dhe të AFA-së. Garanton që veprimtaria e funksionimit të AFA-së të zhvillohet me standardet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar dhe respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen, sigurinë dhe standardet e NATO-s. Nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e politikave të arsimit për personelin oficer.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave të arsimit, të miratuara me urdhër të MM-së. Miraton planet e arsimit, kualifikimit dhe trajnimit individual të personelit. Nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e politikave të arsimit për personelin nënoficer dhe ushtar.

Akademia e Forcave të Armatosura është struktura përgjegjëse për arsimimin, kualifikimin dhe kërkimin shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

Përgjigjet për përgatitjen, arsimimin e kualifikimin e specialistëve të lartë të personelit ushtarak e civil, për fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, kandidatëve për oficerë të rinj në ciklin e parë të studimeve, hartimin e realizimin e programeve të studimit dhe të kualifikimit në të gjitha ciklet e studimit në arsimin e lartë, si dhe arsimimin e kualifikimin, formimin dhe specializimin e nënoficerëve dhe ushtarëve/detarëve aktivë.

Miraton programet mësimore në të gjitha nivelet e kualifikimit ushtarak, civil, institucional dhe funksional. Kryen të gjitha procedurat e përcaktuara me ligj për licencimin dhe akreditimin e programeve të studimit të sistemit të arsimit të lartë.

Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni përgjegjës për diplomimin dhe certifikimin e personelit që ndjek programet e studimit, kualifikimit, trajnimit që zhvillohen pranë saj, si dhe kurseve institucionale të specialiteteve që zhvillohen në njësi e reparte të FA-së. Zbaton dhe monitoron standardet e cilësisë të përcaktuara me ligj dhe akte të tjera nënligjore për arsimin e lartë.

Komandat kryesore dhe ato mbështetëse, si dhe strukturat që janë varësi të MM-së dhe SHP-së marrin përgjegjësi të plotë dhe përgjigjen për zhvillimin e kurseve funksionale të specialiteteve për të gjithë kategoritë e personelit, hartimin e zbatimin e programeve mësimore dhe stërvitore, si dhe certifikimin e kurseve, në bashkëpunim me AFA-në, bazuar në nevojat e strukturave të tyre dhe FA-së.

KREU II

KRITERET E ARSIMIMIT DHE KUALIFIKIMIT PËR TË FITUAR GRADËN E RADHËS

1. Ushtarakët e Forcave të Armatosura për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit, si më poshtë:

Për oficerët:

- a) **Nëntogeri**, për të fituar gradën **“Toger”**, të ketë kryer “Kursin bazë të oficerit” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;
- b) **Togeri**, për të fituar gradën **“Kapiten”**, të ketë kryer “Kursin e avancuar të oficerit” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;
- c) **Kapiteni**, për të fituar gradën **“Major”**, të ketë kryer “Kursin themelor të oficerit të shtabit” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;
- ç) **Majori**, për të fituar gradën **“Nënkolonel”**, të ketë kryer “Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;
- d) **Nënkoloneli**, për të fituar gradën **“Kolonel”**, të ketë kryer “Kursin e lartë të oficerit” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;
- dh) **Koloneli**, për të fituar gradën **“Gjeneral brigade”**, të ketë kryer “Kursin e lartë për sigurinë dhe mbrojtjen” ose kurse të njësura me të, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

- e) gradimi “Gjeneralmajor/Nënadmiral” dhe “Gjenerallejtënant/Admiral” bëhet në bazë të meritave, përgatitjes dhe aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë i Karrierës.

Për nënoficerët:

- a) **Ushtari IV**, për të fituar gradën “**Nëntetari**”, duhet të ketë kryer “Kursin fillestar të nënoficerit”;
- b) **Nëntetari**, për të fituar gradën “**Tetari**”, duhet të ketë kryer “Kursin bazë të nënoficerit”;
- c) **Tetari**, për të fituar gradën “**Rreshter**”, duhet të ketë kryer “Kursin e avancuar të nënoficerit”;
- ç) **Rreshteri**, për të fituar gradën “**Kapter**”, duhet të ketë kryer “Kursin e lartë të nënoficerit”;
- d) **Kapteri**, për të fituar gradën “**Kryekapter**”, duhet të ketë kryer “Kursin e kryekapterit”.

Për ushtarët:

- a) **Kursanti**, për të fituar gradën “**Ushtar/Detari I**”, duhet të ketë kryer stërvitjen individuale bazë;
 - b) **Ushtari/Detari I**, për të fituar gradën “**Ushtar/Detari II**”, duhet të ketë kryer stërvitjen individuale të avancuar.
2. Kurset dhe kualifikimet e kryera brenda dhe jashtë vendit, me urdhër të MM-së dhe SHSHPPFA-së, për efekt të përparimit në gradë, për të gjitha llojet e gradave, njësohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
3. Kurset dhe kualifikimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, që rregullon aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të shërbimit të Policisë Kriminale Ushtarake, njësohen me kurset dhe kualifikimet e kërkuara për marrjen e gradave, sipas këtij dokumenti.

KREU III

ARSIMIMI DHE TRAJNIMI INDIVIDUAL I PERSONELIT USHTARAK

1. TRAJNIMI I USHTARËVE.

Stërvitja e ushtarit ka si qëllim aftësimin profesional e fizik të tij në interes të realizimit të misionit dhe detyrave. Me stërvitje synohet të arrihet niveli operacional, si tregues bazë i gatishmërisë së strukturave të Forcave të Armatosura.

Sistemi i stërvitjes së ushtarit mbështetet në dy kolona kryesore: në Stërvitjen individuale (institucionale), ku struktura përgjegjëse është Akademia e Forcave të Armatosura dhe Stërvitjen kolektive (operacionale), ku përgjegjëse janë njësitë dhe repartet e FA-së.

1.1. Stërvitja individuale ka si qëllim të përgatitë, të formojë dhe të edukojë individë të aftë për të vepruar në fushëbetejë, postë luftimi në anije. Stërvitja individuale është procesi që përgatit ushtarët për të plotësuar rolin individual në operacion, si pjesë e një grupi, skuadre apo ekuipazhi të një anije. Ajo përfshin Stërvitjen individuale bazë (SIB) dhe Stërvitjen individuale të avancuar (SIA), të cilat zhvillohen pa ndërprerje kohore midis tyre.

- a) **Stërvitja individuale bazë (SIB)** ka si qëllim transformimin e të gjithë të rekrutuarve në Forcat e Armatosura, nga qytetarë-civilë në ushtarakë të disiplinuar, të motivuar e të përgatitur moralisht e fizikisht, me atësitë bazë të luftëtarit, për të zbatuar detyrat në operacion si individ dhe në përbërje të një grupi. SIB zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Bunavi, Vlorë dhe zgjat 10 javë. Në përfundim të kursit, rekruti titullohet “Ushtar/Detar” dhe gradohet “Ushtar/Detar I”.
- b) **Stërvitja individuale e avancuar (SIA)** ka si qëllim përgatitjen e ushtarëve aktivë profesionistë në postin e tyre luftarak, sipas specialiteteve të Forcave të Armatosura, për të plotësuar detyrat individuale në përbërje të skuadrës/ekuipezhit. SIA zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Bunavi, Vlorë dhe në Forcën Detare (në anije), menjëherë pas përfundimit dhe certifikimit të SIB-ës dhe caktimit në detyrë në njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura dhe zgjat 10 javë (stërvitore). Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “**Ushtar/Detar II**” dhe vijimin e karrierës së ushtarit/detarit nëpërmjet kryerjes së stërvitjeve të kompaktësimit në njësi e reparte të FA-së deri në “**Ushtar/detar IV**”.

1.2. Stërvitja e kompaktësimit ka si qëllim që, përmes një procesi të shumëllojshëm stërvitjeje individuale dhe kolektive, të përgatitë drejtuesit dhe efektivat me kërkesat e fushëbetejës. Ajo zhvillohet në njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura dhe përfshin stërvitjen individuale përforcuese (stërvitjen në postin luftarak dhe kompaktësimin e skuadrës), si dhe stërvitjen kolektive të repartit e njësisë. Në këtë lloj stërvitje marrin pjesë të gjithë elementët përbërës të luftimit, të mbështetjes në luftim dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit. Stërvitja në njësi, në thelb konsiston në zbatimin e doktrinës në formën e taktikave, teknikave dhe procedurave në mjedise operationale reale. Stërvitja rilidh dhe ripërtërin stërvitjen individuale të pjesëtarëve me stërvitjen e drejtuesve të saj (për ekuipazhet e anijeve të ndara sipas klasit dhe roleve luftarake).

Për raste të veçanta kohëzgjatja e periudhës së SIB/SIA dhe vendi i zhvillimit të tyre mund të ndryshojnë, sipas vlerësimit dhe me urdhër të SHSHPFA-së, me propozim të institucionit arsimor (AFA).

2. ARSIMIMI DHE TRAJNIMI I NËNOFICERIT.

Arsimimi dhe trajnimi i nënoficerit ka si qëllim përgatitjen e mëtijshme dhe konsolidimin e vazhdueshëm të tyre profesionalisht dhe krijimin e piramidës paralele të hierarkisë, si një kontingjent i rëndësishëm, që në mënyrë të dukshme ndikon në rritjen e nivelit operacional dhe stërvitor të Forcave të Armatosura. Arsimimi dhe trajnimi i përgatit nënoficerët të drejtojnë dhe stërvitin ushtarë, grupe ushtarësh dhe nënoficerët vartës, të cilët punojnë apo luftojnë nën drejtimin e tyre. Ky sistem jep drejtim lidërshipi e teknik dhe aftësi për të siguruar që nënoficerët

të jenë të përgatitur për kryerjen e detyrës funksionale dhe atë të specialitetit, për arritjen e suksesit në emërimin e radhës në nivele më të larta përgjegjësie.

Arsimimi i nënoficerit realizohet nëpërmjet kurseve që zhvillohen në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit (QAPN) e në njësi e reparte dhe me kohëzgjatje, si më poshtë:

- Kursi fillestar, **5 javë** në QAPN;
- Kursi bazë, faza e parë **8 javë** në QAPN dhe faza e dytë **8 javë** në njësi e reparte;
- Kursi i avancuar, faza e parë **8 javë** në QAPN dhe faza e dytë **8 javë** në njësi e reparte;
- Kursi i lartë, **8 javë** në QAPN;
- Kursi i kryekapitrit, **8 javë** në QAPN.

2.1. Kursi fillestar i nënoficerit (KFNO).

KFNO ka si qëllim hedhjen e bazave për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësura me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues. Në këtë kurs marrin pjesë Ushtarët/Detarët IV, të cilët kanë rezultuar fitues në procesin e konkurrimit dhe përzgjedhjes. Ky kurs zhvillohet në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit dhe zgjat 5 javë.

2.2. Kursi bazë i nënoficerit (KBNO).

KBNO ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të skuadrës në specialitetin përkatës. Ai u ofrohet të gjithë nënoficerëve që mbajnë gradën “nëndetar”, të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e këtij kursi. Kursi zhvillohet në dy pjesë:

- a) **Pjesa e parë (lidershipi)** ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të tetarit, si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyrave të njësura me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Kjo pjesë zhvillohet në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit dhe zgjat 8 javë.
- b) **Pjesa e dytë (specialitet)** ka si qëllim përgatitjen me njohuri teorike, teknike, menaxhuese në një specialitet ushtarak, me atësitë bazë drejtuese për komandimin e skuadrës në operacione. Ajo zhvillohet në njësitë dhe repartet e FA-së dhe zgjat 8 javë.

2.3. Kursi i avancuar i nënoficerit (KANO).

KANO ka si qëllim përgatitjen e nënoficerit në rol të zëvendëskomandantit të togës në specialitetin përkatës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën “tetar”, të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e këtij kursi. Kursi zhvillohet në dy pjesë:

- a) **Pjesa e parë (lidershipi)** ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të rreshterit, si drejtues në rol të zëvendëskomandantit të togës dhe detyrave të njësura me të, zotërues i teknikave të punës dhe ndihmës kryesor për stërvitjen e togës, si dhe

zhvillimin e aftësive komunikuese dhe drejtuese. Kjo pjesë zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerit dhe zgjat 8 javë.

- b) **Pjesa e dytë (specialitet)** ka si qëllim përgatitjen e tetarëve me njohuritë e nevojshme teorike, teknike, menaxhuese në specialitetin përkatës ushtarak, si dhe jep aftësi bazë drejtuese në rol të zëvendëskomandantit të togës ose detyrave të njësuara me të. Ajo zhvillohet në njësitë dhe repartet e FA-së dhe zgjat 8 javë.

2.4. Kursi i lartë i nënoficerit (KLNO).

KLNO ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të kapterit, si këshilltar i komandantit të nënrepartit ose repartit dhe detyrave të njësuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën “Rreshter”, të cilët janë kualifikuar për ndjekjen e kursit nga komisioni përkatës i karrierës. Zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerit dhe zgjat 8 javë.

2.5. Kursi i kryekapterit (KKK).

KKK ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të kryekapterit, si këshilltar i komandantit të forcës dhe njësisë dhe detyrave të njësuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën “Kapter”, të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e kursit. Kursi zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerit dhe zgjat 8 javë.

3. ARSIMIMI DHE KUALIFIKIMI I OFICERËVE.

Arsimimi i kandidatëve për oficerë kryhet:

- Në Akademinë e Forcave të Armatosura-Programe të arsimit të lartë (cikli i parë) Bachelor;
- Në Akademinë e Forcave të Armatosura -Kursi i përgatitjes së oficerit të ri;
- Në Akademitë Ushtarake jashtë vendit – sipas planeve të bashkëpunimit dypalësh.

4.1. Arsimimi i kandidatëve në programin e arsimit të lartë (cikli i parë) Bachelor

Pas përfundimit të procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve nga AFA-ja, studentët kandidatë për oficerë do të ndjekin programet e studimeve Bachelor, në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Programet e studimit kanë për qëllim të përgatisin oficerët e rinj me njohuri bashkëkohore, të aftë fizikisht dhe profesionalisht, bazuar në nevojat e FA-së. Këto programe studimi të ciklit të parë Bachelor të ofruara në AFA, orientohen drejt dhënies së njohurive bazë rreth rolit, misionit, organizimit dhe funksionimit të FARSH-it, si dhe bazave të lidërshit, menaxhimit, etikës dhe lëndëve të tjera për t'i përgatitur ata të shërbejnë si oficerë karriere.

Këto programe studimi zgjatin 3 (tri) vite akademike me 180 kredite (ECTS), referuar nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve (KSHK).

Studentët që përfundojnë me sukses programet e studimit, pajisen me diplomë të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, titullohen **“Oficer aktiv”** dhe gradohen **“Nëntoger/Nënlejtënant”**.

4.2. Arsimimi i kandidatëve me arsim të lartë që do të ndjekin “Kursin e përgatitjes së oficerit”.

Kandidatët për oficerë me arsim të lartë do të përgatiten në interes të plotësimit të nevojave të FA-së me specialistë të fushave të ndryshme, si: ekonomistë, financierë, juristë, inxhinierë elektrikë, elektronikë, informatikë, topografi etj. Pas rekrutimit nga Qendra e Personel Rekrutimit, këta kandidatë do të zhvillojnë Programin e Arsimit të Plotë, pa ndërprerje, në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ky program do të zhvillohet në një vit akademik, i ndarë në dy faza:

- a) **Faza e parë, Stërvitja individuale bazë e oficerit të ri**, e cila ka si qëllim transformimin e të gjithë rekrutëve, nga qytetarë-civilë në ushtarakë të disiplinuar, të motivuar e të përgatitur moralisht e fizikisht. Ajo zhvillohet në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA dhe zgjat 10 javë.
- b) **Faza e dytë, Arsimimi i përgjithshëm i oficerit të ri**, e cila ka si qëllim të edukojë, trajnojë dhe të frymëzojë kandidatët për oficerë në nivelin e komandantit të togës për të qenë lider me karakter, intelektualisht, profesionalisht dhe fizikisht të aftë për të shërbyer dhe drejtuar në Forcat e Armatosura. Kjo fazë zhvillohet në AFA dhe zgjat 27 javë.

Kursantët që përfundojnë “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri” titullohen **“Oficer aktiv”** dhe gradohen **“Nëntoger”**.

4.3. Arsimimi i kandidatëve në akademitë/shkollat ushtarake jashtë vendit.

Përgatitja e kandidatëve të përzgjedhur për ndjekjen e studimeve në akademitë/shkollat ushtarake jashtë vendit bëhet në bazë të programeve të studimeve të shkollave/akademive ushtarake, ku do të ndjekin studimet kandidatët, të cilat zakonisht sigurojnë edhe dhënien e një diplome universitare të ciklit të parë ose të dytë, në degë të ndryshme studimi.

Pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve ushtarake, studentët titullohen **“Oficer aktiv”** dhe gradohen **“Nëntoger/Nënlejtënant”**.

4.4. Kurset institucionale.

Përgatitja e oficerëve është një proces i vazhdueshëm. Pas titullimit “Oficer aktiv” dhe gradimit “Nëntoger/Nënlejtënant”, oficerët kalojnë nëpër disa kurse formimi dhe kualifikimi, të cilat janë të domosdoshme si për thellimin e njohurive e përgatitjen e tyre profesionale, ashtu edhe për zhvillimin e karrierës ushtarake. Kurset institucionale që ndjekin oficerët janë:

- Kursi bazë i oficerit;
- Kursi i avancuar i oficerit;
- Kursi themelor i oficerit;
- Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm;
- Kursi i lartë i oficerit;
- Kursi i lartë për sigurinë dhe mbrojtjen.

4.4.1. Kursi bazë i oficerit (KBO).

KBO ka si qëllim përgatitjen e oficerëve të rinj me njohuritë teorike, teknike, menaxhuese në një specialitet ushtarak, me aftësitë bazë taktike dhe drejtuese për komandantin e togës në operacion, si dhe të japë njohuri për drejtimin e kompanisë. Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët që mbajnë gradën “Nëntoger/Nënlejtënant”.

Kursi zhvillohet në njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura, me kohëzgjatje 12-24 javë, në varësi nga specialiteti përkatës. Për specialitetin “detar” dhe “specialist furnizimi” kohëzgjatja e kursit është 24 javë, ndërsa për specialitetin “teknik helikopteri” kohëzgjatja e kursit është 30 javë. Për specialitetin “pilot ushtarak helikopteri” kohëzgjatja e kursit është 49 javë (13 javë teori dhe 36 javë praktikë fluturuese).

Oficerët që mbarojnë studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit, “Kursin bazë të oficerit” mund ta kryejnë në shkollat ushtarake brenda ose jashtë vendit, në varësi të marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe kualifikimit me vendet aleate dhe partnere.

4.4.2. Kursi i avancuar i oficerit (KAO).

KAO ka si qëllim të thellojë aftësitë, njohuritë teorike, teknike dhe menaxhuese në specialitetin ushtarak përkatës, të togerëve/lejtënantëve, përgatitjen e tyre me aftësitë bazë taktike dhe drejtuese për komandimin e kompanisë në operacione të ndryshme luftarake dhe joluftarake, si dhe të japë njohuri për batalionin. Në këtë kurs marrin pjesë oficerët që kanë kryer KBO, kanë gradën “Toger/Lejtënant” dhe janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e KAO-së.

Kursi zhvillohet pranë njërive dhe reparteve të FA-së, me kohëzgjatje 12 javë.

4.4.3. Kursi themelor i oficerit të shtabit (KTHOSH).

KTHOSH ka si qëllim përgatitjen e oficerëve të shtabit të batalionit ose strukturave ekuivalente, dhënien e njohurive në nivelin e brigadës, si dhe përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vijuar karrierën si oficerë profesionistë.

Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Forcës Detare dhe Ajrore, të cilët mbajnë gradën “Kapiten/Kapitenlejtënant” dhe janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e kursit themelor.

Kursi zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat 14 javë.

4.4.4. Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP).

KKSHP ka si qëllim përgatitjen e oficerëve të karrierës për të kryer detyra në nivel komandant batalioni dhe shtabi brigade/force ose struktura ekuivalente dhe jep njohuri për nivelin operativ-strategjik.

Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Forcës Detare dhe Ajrore, të cilët kanë kryer KTHOSH, mbajnë gradën “Major/Kapiten i rangut të tretë” dhe që janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e “Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm”.

Kursi zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat një vit akademik.

4.4.5. Kursi i lartë i oficerit (KLO).

KLO ka si qëllim përgatitjen e oficerit të karrierës për të kryer detyra në nivelin operativo-strategjik.

Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Forcës Detare dhe Ajrore, të cilët kanë kryer KKSHP, mbajnë gradën “Nënkolonel /Kapiten i rangut të dytë” dhe që janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e KLO-së.

Kursi zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat një vit akademik.

4.4.6. Kursi i lartë i sigurisë dhe mbrojtjes (KLSM).

KLSM-ja ka si qëllim aftësimin e ushtarakëve dhe civilëve të niveleve strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë së vendit.

Kursi zhvillohet në AFA, për një periudhë 3-mujore. Ai zhvillohet në anglisht dhe në të marrin pjesë ushtarakët që kanë kryer KLO-në, mbajnë gradën “Kolonel” dhe janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e kursit. Gjithashtu, marrin pjesë civilë ekuivalentë nga FA-ja, nga institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë në vend, si dhe ushtarakë nga vendet aleate dhe partnere.

5. PROGRAME TË TJERA STUDIMI, KURSE DHE SEMINARE.

5.1. Akademia e Forcave të Armatosura, si institucion i vetëm i Arsimit të Lartë Publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë zhvillon programet e mëposhtme të nivelit universitar:

- a) Programi i ciklit të dytë të studimeve “**Master profesional**” në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë referuar nivelit 7 të (KSHK). Të gjithë oficerëve ose nënoficerëve që kanë kryer studimet “Bachelor” u ofrohet mundësia të ndjekin edhe programin e studimeve “Master profesional”. Programi është i hapur edhe për kandidatë nga institucione të tjera të sigurisë në bazë të kuotave të miratuara nga Organet Kolegjiale, pranë AFA-së.
- b) Programi i ciklit të dytë të studimeve “**Master shkencor**” në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, referuar nivelit 7 të (KSHK). Ky program studimi u ofrohet oficerëve që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimi të Institucionit të Arsimit të Lartë, sipas legjislacionit në fuqi. Programi është i hapur edhe për kandidatë nga institucione të tjera të sigurisë në bazë të kuotave të miratuara nga Organet Kolegjiale, pranë AFA-së.
- c) Programi i ciklit të tretë të studimeve “**Master ekzekutiv**” në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë referuar nivelit 8 të (KSHK). Ky program studimi u ofrohet oficerëve/civilëve që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë dhe plotësojnë kriteret e pranimi të Institucionit të Arsimit të Lartë, sipas legjislacionit në fuqi. Ky program ofron arsimimin e një niveli të lartë shkencor dhe profesional, me qëllim thellimin e njohurive në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe vendosjen e tyre në interes dhe shërbim të çështjeve studimore dhe kërkimore me interes për FA-në. Programi është i hapur edhe për

kandidatë nga institucione të tjera të sigurisë në bazë të kuotave të miratuara nga Organet Kolegjiale, pranë AFA-së.

- d) ç) Programi i ciklit të tretë studimet e doktoratës, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes referuar nivelit 8 të (KSHK), mundësohet nga Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e tjera të Arsimit të Lartë të RSH-së, bazuar në nevojat e Forcave të Armatosura, të miratuara nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ministri i Mbrojtjes. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale, për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Ky program studimi u ofrohet oficerëve/civilëve që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, sipas legjislacionit në fuqi. Programi është i hapur edhe për kandidatë nga institucione të tjera të sigurisë në bazë të kuotave të miratuara nga Organet Kolegjiale, pranë AFA-së.

5.2. Programet e zhvillimit të gjuhës së huaj.

Qendra e Gjuhëve të Huaja, në Akademinë e Forcave të Armatosura, është institucioni i vetëm i autorizuar për zhvillimin e programeve, procedurave, standardeve të testimit dhe certifikimit të personelit në Forcat e Armatosura.

Qëllimi i trajnimit në gjuhën e huaj është mbikëqyrja e kualifikimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit, zhvillimi i karrierës, si dhe pjesëmarrja në misione të ndryshme jashtë vendit.

Mbështetur në politikën e gjuhëve të huaja, trajnimi i personelit të FA-së në gjuhën angleze, të bëhet sipas STANAG-ut 6001.

Zhvillimi i kurseve intensive të gjuhës angleze për nivelin 2/2/2/2, 3/2/3/2 dhe 3/3/3/3 të bëhet në QGJH, ndërsa për nivelet 1/0/1/0, 1/1/1/1 dhe 2/1/2/1 të bëhet në njësitë e repartet parësore të FA-së, duke angazhuar në rolin e instruktorit të gjuhës oficerët dhe nënoficerët e trajnuar për këtë qëllim.

Testimet për përcaktimin e shkallës së njohurive të gjuhës së huaj të bëhen në bazë të procedurave të STANAG-ut 6001 dhe ALCPT-së/ELPT-së. Pasqyrimi i të dhënave në database të bëhet pas çdo faze testimi dhe ato të jenë të vlefshme për çdo kualifikim, gradim, trajnim, aktivitet brenda dhe jashtë vendit etj.

Kurset afatshkurta për trajnimin e personelit për terminologjinë operacionale të bëhen kryesisht për personelin që shkon në operacione jashtë vendit, me qëllim rifreskimin dhe ruajtjen e nivelit gjuhësor në bazë të nevojave të Forcave të Armatosura.

5.3. Kurse dhe seminare të tjera.

Krahas kurseve institucionale për zhvillimin e karrierës së oficerëve, Akademia e Forcave të Armatosura dhe komandat e forcave/komandat mbështetëse ofrojnë programe dhe organizojnë kurse dhe seminare, sipas nevojave të Forcave të Armatosura. Në këto kurse mundësohet trajnimi i kontingjenteve ushtarake dhe civile të Forcave të Armatosura të

Republikës së Shqipërisë, që janë përzgjedhur për të shërbyer në misione dhe përfaqësitë jashtë vendit.

5.4. Kurse funksionale.

Kurset funksionale (On job training) kanë si qëllim aftësimin e personelit ushtarak dhe civil në kryerjen e detyrave funksionale për nevoja informuese dhe familjarizuese me standarde dhe procedura të reja të NATO-s, armatime apo sisteme të reja modernizimi, si dhe aftësimin e personelit ushtarak dhe civil që merr pjesë në operacionet e drejtuara nga NATO/OKB/BE etj. Këto kurse do të zhvillohen dhe certifikohen nga komandat e njësisë, reparteve dhe drejtuesit e shërbimeve.

5.5. Kurse profesionale.

Kurset profesionale kanë si qëllim aftësimin e personelit ushtarak dhe civil në një fushë specifike profesionale për plotësimin e nevojave të FA-së. Njohuritë dhe shprehitë e marra në këto kurse, i shërbejnë personelit gjatë kohës së shërbimit në Forcat e Armatosura, si dhe pas përfundimit të këtij shërbimi, në jetën civile. Këto kurse njihen edhe nga autoritetet/institucionet shtetërore e private përkatëse. AFA-ja do të jenë struktura që do të realizojë bashkëpunimin me institucionet përkatëse.

5.6. Kurset dhe kualifikimet ushtarake jashtë vendit.

Shkollat dhe kurset e trajnimit jashtë vendit zhvillohen mbi bazën e planit të bashkëpunimit që kanë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë me këto vende. Personeli ushtarak për ndjekjen e këtyre kurseve përzgjidhet sipas procedurave dhe kritereve të miratuara me rregullore të veçantë.

Referencat ligjore:

- Ligji 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë;
- VKM nr 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”.
- Ligji 121/2015 “Plani Afatgjatë i zhvillimit të FARSH 2016-2025”;
- Ligji 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të FARSH”, i ndryshuar;
- Dokumenti i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, 2019;
- Direktiva e ministrit të Mbrojtjes, 2020;
- Doktrina e Arsimit dhe Stërvitjes në FARSH MP-3-4, 2014;
- Dokumenti “Politika dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FA”, miratuar me urdhër të MM nr. 925, datë 03.08.2020.